



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 400/01-9934 dt. 29.02.2024

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338, dt. 7.4.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Vendimit të Kuvendit të Drenasit më 27.9.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.02.2024, miratoi këtë:

VENDIM
për Subvencionimin e nënave lehona

- I. Miratohet Vendimi për Subvencionimin e nënave lehona (për të porsalindurit e tyre).
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, në subvencionim përfshihen të gjitha nënat lehona me adresë të vendbanimit në Komunën e Drenasit që kanë lindur fëmijë nga data 01.01.2024 e tutje, dhe do të subvencionohen me shumën 100.00 € (njëqind euro).
- III. Mjetet financiare do të paguhen nga nën-programi 73010 Administrata (Drejtoria e Shëndetësisë), përkatësisht, nga kategoria ekonomike e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, burimi i financimit nga të hyrat vetanake.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale.
- V. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari
Milaim Hajdari

ARSYETIM

Në Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Drenasit, më 27.09.2023, ku është paraqitur për aprovim dhe është aprovuar buxheti për Subvencionimin e lehonave, me njëqind (100) euro.

Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, do të zbatoj këtë vendim të Kuvendit të Drenasit, të miratuar njëzëri.

Çështja e subvencioneve është rregulluar përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare, sipas kriterëve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti, propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave, Kryetari propozon të aprovohet kërkesa e cekur më lartë.